

VENDIM
Nr.71, datë 7.2.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.841, DATË 13.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E ANËTARËVE NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR
VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE
MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.841, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 2, pas fjalëve “... jo më shumë se tre persona për secilën kategori vlerësimi...” të shtohen “... duke përjashtuar nga ky rregull pagesën për anëtarët e aktivizuar gjatë vitit 2006...”.
 - b) Pika 4 shfuqizohet.
2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha